



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Nehat Haliti, me titull:
“Mënyrat e kultivimit të fidanit dhe aftësitë prodhuese të kultivarit polka”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 09 deri me datë 16.10.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Mentor Thaqi anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu , përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI

Tema:

**MËNYRAT E KULTIVIMIT TË FIDANIT DHE AFTËSITË
PRODHUESE TË KULTIVARIT POLKA**

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Nehat Haliti

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Në pronën private në Dumnicë të Vushtrrisë gjatë vitit 2017 është ngritur parcela eksperimentale për hulumtimin e vetive agrobiologjike të kultivarit të mjedrës Polka. Në këtë rast qëllimi i hulumtimit ka qenë testimi i përdorimit të dy llojeve të fidanëve: fidanë të pjekur dhe fidanë të gjelbër. Për secilin variant janë përfshirë tri përsëritje me nga 10 bimë që përafërsisht 3 bimë kanë qenë në 1 m gjatësi të rendit, të vendosura në mënyrë të rastit sipas planit të rastësishëm në bllok të randomizuar. Në studim janë përfshirë hulumtimi i disa parametrave biomorfologjik: biologjik (dinamika e pjekjes së frutave) morfologjik (lartësia e lastarëve, numri i degëzave frutore për lastarë, gjatësia e degëzave frutore, numri i gjetheve për lastar, parametrat e gjethit – gjatësia, gjerësia e gjethëzave, gjatësia e gjethit dhe sipërfaqja e gjethit), treguesit frutdhënës (numri i lulërive për lastar, numri i frutave për lastarë, prodhimi për lastarë dhe hektar), pomologjik (lartësia, gjerësia thellësia e gropëzës, pesha dhe indeksi i frytit), dhe biokimik (materia e thatë, sheqeri Brix, , aciditeti, pH). Nga rezultatet e hulumtuara vërejmë një numër të ndryshimeve në parametrat bio-morfologjik në mes të varianteve. Dy variantet me fidan të pjekur dhe me fidan të gjelbër kanë shfaqë një dinamikë të ngjashme të pjekjes së frutave. Varianti fidan i pjekur ka treguar gjatësi më të madhe të lastarëve (117.8cm) ndërsa varianti fidan i gjelbër ka treguar numër më të madh të degëzave frutore për lastar (3.28) dhe me gjatësi më të madhe (69.38 cm). Te parametrat gjethor nuk janë shfaqë ndryshime të rëndësishme në mes varianteve. Në treguesit frutdhënës varianti me fidan të gjelbër ka shfaqur vlera më të larta në të gjithë parametrat e analizuar (29 lulëri / lastar, 100.96 fruta / lastar, 2206.6 gram / bimë, 22096 kg /ha). Edhe te përmasat e frytit varianti fidan i gjelbër ka treguar vlera më të larta gjatësia e frytit (20.23 mm), gjerësia (17.76 mm), thellësia e gropëzës së frytit (17.38 mm) dhe peshë e frytit (3.12 g). Vlen të theksohet se në kuadër të kësaj dy variantet kanë treguar vlera më të larta të parametrave në fillim të pjekjes se në përfundim të pjekjes. Pas analizimit të parametrave biokimik të frutave ndryshimet e shfaqura në mes varianteve nuk kanë qenë të rëndësishme në aspektin statistikor.

Fjalët kyçe: Mjedra, fidan i pjekur, fidan i gjelbër, parametrat biomorfologjik.